

**VENDIM**  
**Nr. 61, datë 3.2.2017**

**PËR MIRATIMIN E PAKETAVE TË PAJISJEVE MJEKËSORE TË RIMBURSUESHME**

*(I shtuar me vendimin nr. 814, datë 29.12.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në vendimin nr. 61, datë 3.2.2017, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e paketave të pajisjeve mjekësore të rimbursueshme’)<sup>1,2,3</sup>*

***I përditësuar***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Paketa e pajisjeve mjekësore të rimbursueshme, si pjesë e paketave të shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, financohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, sipas legjislacionit në fuqi.
  2. Lista e pajisjeve mjekësore hartohet nga komisioni teknik i listës së pajisjeve mjekësore të rimbursueshme, i cili ngrihet me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit.
  3. Komisioni përfshin në listën e pajisjeve të rimbursueshme, pajisje të cilat janë të regjistruara dhe plotësojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi për pajisjet mjekësore.
  4. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda datës 30 shtator të çdo viti, i dërgon Ministrisë së Shëndetësisë, listën e pajisjeve mjekësore të importuara dhe të prodhuara gjatë vitit kalendarik, si dhe subjektet përkatëse importuese e prodhuese.
  5. Ministri i Shëndetësisë, brenda datës 15 tetor të çdo viti, i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave çmimet e deklaruara nga subjektet importuese të regjistruara të pajisjeve mjekësore gjatë vitit kalendarik.
  6. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, brenda 20 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës për informacion, dërgon pranë Ministrisë së Shëndetësisë çmimet e deklaruara nga importuesit dhe prodhuesit e regjistruar të pajisjeve mjekësore gjatë vitit kalendarik.
  7. Ministria e Shëndetësisë i dërgon Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor informacionin për pajisjet mjekësore, importuesit dhe prodhuesit, si dhe çmimet e importit, të mbledhura nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore e Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti.
  8. Lista e pajisjeve mjekësore, e përfunduar nga komisioni, i paraqitet për miratim Këshillit Administrativ të Fondit.
  9. Marzhet e tregtimit me shumicë dhe pakicë në rrjetin e hapur farmaceutik, si dhe marzhet e tregtimit të rrjetit spitalor, përcaktohen çdo vit, bashkë me listën përkatëse vjetore.
- 9/1. Përyjashtimisht, lista e pajisjeve mjekësore që do të rimbursohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për vitin 2018, për pacientët e grup-moshës 0–18 vjeç, është sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.<sup>4</sup>*

<sup>1</sup> Në pikën 2, të vendimit nr. 814, datë 29.12.2017, të Këshillit të Ministrave, të botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 236, datë 4 Janar 2018, përcaktohet se “Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.”;

<sup>2</sup> Në pikën 3, të vendimit nr. 814, datë 29.12.2017, të Këshillit të Ministrave, të botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 236, datë 4 Janar 2018, përcaktohet se “Ngarkohet Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.”;

<sup>3</sup> Në fjalinë e fundit të vendimit nr. 814, datë 29.12.2017, të Këshillit të Ministrave, të botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 236, datë 4 Janar 2018, përcaktohet se “Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.”;

<sup>4</sup> Pika 9/1 është shtuar në zbatim të pikës 1, të vendimit nr. 814, datë 29.12.2017, të Këshillit të Ministrave, të botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 236, datë 4 Janar 2018;

10. Lista e pajisjeve mjekësore të rimbursuara, e miratuar nga Këshilli Administrativ i Fondit, i dërgohet Ministrisë së Shëndetësisë për të vijuar procesin e miratimit pranë Këshillit të Ministrave.

11. Për vitin 2017, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, do të dërgojnë informacionin e përcaktuar në këtë projektvendim në Ministrinë e Shëndetësisë, brenda datës 28 shkurt 2017.

12. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Niko Peleshi

SHTOJCA NR. 1<sup>5</sup>  
LISTA E PAJISJEVE MJEKËSORE TË RIMBURSUESHME QË TREGTOHEN NË FARMACITË E SPITALEVE

Nr.	Emri i pajisjes	Emërtimi i pajisjes sipas regjistrit të AKBPM-së	Njësia	Importuesi	Prodhuesi	Çmimi i tregtimit me shumicë/njësi në lekë, me TVSH	Çmimi i pacientit	Rimbursimi
1/1	Fisha Diabeti	Smart Chek II Blood Glucose Meter Set 1000300039; Smart Chek II Blood Test Strips 200020091	Fishë	Euomed	Major Biosystem Corp. 7F., No. 186, Jian-Yi RD., Jung-He District 285 New Taipei City Taiwan	20	0	20
1/2	Fisha Diabeti	Aparat eBsensor; Fische eBsensor	Fishë	Capo-Ap	Visgenër Inc. No. 335, Sec. 6, Zhonghua Rd. 30094 Hsinchu City Taiëan	27	7	20
1/3	Fisha Diabeti	Aparat dhe fisha glicemie Açuçek active Açuçek-Active Model GB mg/dl kit 07133767; Açuçek-Active Model 07124112	Fishë	KoslaborAlb	Roche Diagnostics GmbH Sandhofer Str.116 68305 Mannheim Germany	28	8	20
1/4	Fisha Diabeti	Blood Glucose measuring systems 23913; 23916	Fishë	Net electronics	Acon Laboratories, Inc. 10125 Mesa Rim Road San Diego CA 92121 USA	32	12	20
1/5	Fisha Diabeti	Blood Glucose/Blood Glucose Meter Test Strips Contour Plus/84578240/ 84581926	Fishë	Trimed	Ascensia Diabetes Care Holdings AG Peter MerianStrasse 90, 4052 Basel Switzerland	40	20	20
1/6	Fisha Diabeti	OTSelectPlus Strip 1x50; OTSelect Strip 1x 50; OTUltra Strip 50; OTSelectPlusFle x System; OTSelectPlus System	Fishë	Megastore	Lifescan Europe, A Div. of Cilag GmbH International Gubelstrasse 34 6300 Zug Switzerland	40	20	20

\* Kompanitë importuese kanë deklaruar dhënien falas të aparateve për matjen e glicemisë, si edhe gjilpërave shpuese (1 në ditë).

<sup>5</sup> Shtojca Nr. 1 është shtuar në zbatim të pikës 1, të vendimit nr. 814, datë 29.12.2017, të Këshillit të Ministrave, të botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 236, datë 4 Janar 2018.

**VENDIM**  
**Nr. 318, datë 15.5.2019**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 61, DATË 3.2.2017, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PAKETAVE TË PAJISJEVE MJEKËSORE TE**  
**RIMBURSUESHME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pika 9/1, e vendimit nr. 61, datë 3.2.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9/1. Lista e pajisjeve mjekësore që do të rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për vitin 2019, për pacientët e grupmoshës 0—25 vjeç, është sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.”

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për vitin 2019.

3. Ngarkohet Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

Shtojca nr. 1

Lista e pajisjeve mjekësore të rimbursueshme që tregtohen në farmacitë e spitaleve

NR.	Emri i pajisjes	Emërtimi i pajisjes sipas regjistrat të AKBPM	Njësia	Importuesi	Prodhuesi	Çmimi i tregtimit me shumicë/njësi në lekë, me TVSH	Çmimi i pacientit	Rimbursimi
1/1	Fisha Diabeti	Smart Check II Blood Test Strips 200020091	Fishë	Euromed shpk	Major Biosystem Corp. 7F, No.186, Jian-Yi RD., Jung He District 285 New Taipei City Taiwan	0	19	
1/2	Fisha Diabeti	Blood Glucose Test Strips	Fishë	O.E.S Distrimed shpk	Hangzhou Sejoy Electronics & Instruments Co., Ltd. Building 2, No. 202, Zhenzhong Road West Lake Economy & Technology Zone 310030 Hangzhou China	0	19	
1/3	Fisha Diabeti	Onetouch	Fishë	Megastore shpk	Lifescan Europe, A Div. of Cilag GmbH International Gubelstrasse 34 6300 Zug Switzerland	0.92	19	
1/4	Fisha Diabeti	Aparat eBsensor; Fishe eBsensor	Fishë	Capo-Al shpk	Visgencer Inc. No.335, Sec.6, Zhonghua Rd. 30094 Hsinchu City Taiwan	2	19	
1/5	Fisha Diabeti	Contour Plus	Fishë	Trimmed shpk	Ascensia Diabetes Care Holdings AG Peter Merian- Strasse 90, 4052 Basel Switzerland	21	19	